



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

I	Data	19.06.26	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		370/01-14855	/

KONTRATA PËR SHËRBIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga Z/Izahir Kuka, Menaxher i prokurimit; në njërën anë dhe

Kompania e sigurimeve të përgjithshme "SIGUARIA" SH.A nga Prishtina (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuari Z/Artan Morina nga Gjilani, me nr.personal 1232013555 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Shërbimet e sigurimit dhe kontrollës teknike të automjeteve të komunës së Kaçanikut

me numër Identifikues: 652-26-2387-2-3-6

KA652/026/029/236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Shërbimet e sigurimit dhe kontrollës teknike të automjeteve të komunës së Kaçanikut**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 19.06.2026 dhe përfundon më 18.06.2027

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 365 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi Komuna Kaçanik

1.5 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 8,457.21 €;

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

me fjalë (Tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë euro, e njëzet e një cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimi të shërbimit

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për ___%___ muaj, pas pranimi të **shërbimit**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e

caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Z/ Artan Morina	Emri:	Z/Izahir Kuka
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.06.2026	Data:	19.06.2026
Vula:		Vula:	

SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMIT DORËTËNË PËR QATË COMPANY





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



KRYETARI I KOMUNËS

01 Nr. 370/01-14859

Kaçanik, 24.06.2026

Në bazë Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të
Rregullores 001/2022 Për Prokurimi Publik nenit 70 , Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

I. Me këtë vendim emërohet Menaxher i projektit **Saimir Murseli** në projektin: **Shërbimet e sigurimit dhe kontrollës teknike të automjeteve të komunës së Kaçanikut** Në bazë të kontratës **01NR.370/01-14859** të datës **19.06.2026**

II. Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur, do të raportoj me shkrim ZKA, Zyren e Prokurimit, **DAP** mbi realizimin e punëve në teren.

III. Sipas këtij vendimi Menaxherët e projektit do të jenë të angazhuar në procesin e implementimit të projektit, bazuar në përgjegjësit sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit Publik.

IV. Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Zyra e prokurimit , OE dhe **DAP**



Kryetari i komunës
Z. Sabedin Vishi

SPECIFIKACIONI I ÇMIMEVE PËR VETURAT

NR	LLOJI I AUTOMJETIT	KAPACITETI M3	NJISIA	SASIA	SIGURIMI TPL	KONTROLLA TEKNIKE	TOTALI
1	GOLF 4	1896	copë	3	€ 194.25	€ 30.00	€ 672.75
2	DACIA SANDERO	999	copë	1	€ 110.57	€ 30.00	€ 140.57
3	HONDAY	1598	copë	2	€ 156.89	€ 30.00	€ 373.78
4	LANDROVER	1951	copë	2	€ 233.10	€ 30.00	€ 526.20
5	PEZHO 308	1400	copë	1	€ 137.47	€ 30.00	€ 167.47
6	DACIA SANDERO	1461	copë	2	€ 137.47	€ 30.00	€ 334.94
7	NISAN QASHQA	1749	copë	1	€ 194.25	€ 30.00	€ 224.25
8	TOJOTA PRADA	2982	copë	1	€ 313.79	€ 30.00	€ 343.79
9	MINI BUS 23 ulese Nderurban	23 ulëse	copë	1	€ 690.30	€ 50.00	€ 740.30
10	KOMBI T 4	2461	copë	1	€ 268.96	€ 30.00	€ 298.96
11	PIKAP CANDY	1896	copë	1	€ 194.25	€ 30.00	€ 224.25
12	PEZHO BOKSER	1997	copë	3	€ 233.10	€ 30.00	€ 789.30
13	KOMBI T 6	2461	copë	1	€ 268.96	€ 30.00	€ 298.96
14	FIAT DUKATO	2287	copë	1	€ 268.96	€ 30.00	€ 298.96
15	CITREN JUPER	2198	copë	1	€ 233.10	€ 30.00	€ 263.10
16	TOJOTA LAN KROSER	4164	copë	1	€ 313.79	€ 30.00	€ 343.79
17	KOMBI T7	2461	copë	1	€ 268.96	€ 30.00	€ 298.96
18	PEUGET PARTNER (Transporter)	1.5	copë	1	€ 156.89	€ 30.00	€ 186.89
19	OPELL MOVANA	2.2	copë	1	€ 233.10	€ 30.00	€ 263.10
20	DIAMTER BENZIN LAF 1113/B	4.9 T	copë	1	€ 359.90	€ 30.00	€ 389.90
21	BMC FATIH 200/26	6.5 T	copë	1	€ 418.90	€ 30.00	€ 448.90
22	RENAULT JNIA12	3.9 T	copë	1	€ 359.90	€ 30.00	€ 389.90
23	AUTO IVECO PER SHURJE ZIARRI PESHA 3960 NGARKESA 1540	2998	copë	1	€ 240.72	€ 30.00	€ 270.72
24	SUZUKI VITARA	1.4	copë	1	€ 137.47	€ 30.00	€ 167.47
TOTALI					€ 6,125.05	€ 740.00	€ 8,457.21
							€ 7,167.13